

SHPALLJE

PËR PUNË PRKTIKE PËR STUDENT

Organizata "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK), është duke zbatuar projektin **"Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës"** projekt trevjeçar (2020-2022), i përkrahur nga Donatori Bread for the Word nga Gjermania. Projekti do të përfshijë komunat: Vushtrri, Shtime, Viti dhe Kamenicë.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar edhe përkrahja e të rinjëve-studentëve me punë praktike, si mundësi për punësim apo vetë-punësim. Përmes këtij aktiviteti paraprkishtë do të organizohen 5 ditë trajnime profesionale të aftësive të buta. Pas përfundimit të trajnimeve, studentët do të sistemohen në punë praktike në kompani/institucione përkatëse, për të cilat ata kanë vendosur paraprkishtë.

Këto aktivitete do të zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me komunat përkatëse ku shtrihet projekti, pastaj me Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, si dhe institucionet (kolegjet) tjera arsimore, të cilat në fushëveprimtarinë e tyre e kanë edhe bujqësinë apo teknologjinë ushqimore.

Andaj ftohen të rinjtë-studentët e drejtimit të bujqësisë dhe të teknologjisë ushqimore, që të aplikojnë për angazhimin në praktika të ndryshme që përshtaten me profesionin e tyre. Gjatë zbatimit trevjeçar të projektit do të përkrahen gjithsej 45 të rinjë-student me punë praktike, apo çdo vit do të përfshihen nga 15 student. Ky grup do të kryej punë praktike në kompani, institucione dhe organizata të ndryshme, ku gjatë punës praktike në periudhë prej 3 muajve, të rinjtë/studentët do të kenë një kompensim në baza mujore për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe komunikimit. Kandidatët e përzgjedhur duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara me projekt.

KRITERET QË DUHET PLOTËSUAR KANDIDATËT JANË :

- a) Student të cilët kanë diplomuar viteve të fundit apo që janë në përfundim të studimeve të drejtimit të bujqësisë (përfshirë teknologjinë ushqimore);
- b) Student të papunë dhe që nuk kanë kryer praktikë më parë;
- c) Studentët që shprehin gatishmëri/përkushtim për pjesëmarrje në trajnime dhe në punë praktike në kompani/agrobiznese, institucione dhe organizata tjera;
- d) Studentët të interesuar për praktikë duhet të jenë nga këto komuna: Vushtrri, Shtime, Viti dhe Kamenicë;

Aplikacioni mund të merren në **zyrat e IADK-së**, në adresë fshati Sfarçak i Ulët, Nr.11, ose mund t'i kërkon në e-mailin: hasan.cena95@gmail.com. Aplikacioni mund të dorëzohet në **zyrat e IADK-së** ose përmes e-mailit: hasan.cena95@gmail.com.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në 049 973 211 .

***Shënim: Informata shtesë mund t'i merrni në sesionet informuese që do të organizohen nga IADK në komunat përkatëse.**

Konkursi për aplikim është i hapur nga data 06.03.2020 deri më 18.03.2020.